



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, nenit 17, shkronja **b** dhe neni 40 shkronja **l** të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.3, nenit 17, paragrafët 1, 7 dhe 9, dhe nenit 26 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174, dt. 31.07.2013, dhe të Udhëzimit administrativ nr. 41, 02/05 për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban, të nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.04.2017, merr këtë

VENDIM

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM TË BLOKUT A-1 TË LAGJES "DODONA"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A-1 të lagjes "Dodona".

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me hartimin e Planit rregullues të hollësishëm, në kuptim të nenit 1 i këtij Vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, si dhe rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Kufiri i territorit

Në bazë të Planit rregullues të hollësishëm, në kuptim të nenit 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e përfshirë në kuadër të Planit zhvillimor komunal të komunës së Prishtinës, dhe parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonës kadastrale Prishtinë, e cila ka një sipërfaqe prej $S= 3.87$ ha.

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, në kuptim të nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projektpropozimi i Planit rregullues të hollësishëm para finalizimit, duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Propozimplanit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm, në kuptim të nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-350/01-0093751/17, më 24.04.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.